



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 495

Datë: 20.08.2021

Procesverbal

i mbledhjes se -IV- (jashtëzakonshme) për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi i kërkesave
2. Të ndryshme

Mbledhja u mbajt me datë: 05.07.2021 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 6 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve rëndin e ditës Halil Morina ka treguar që s'mund me marrë pjesë në mbledhje. Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/346 datë: 23.06.2021 e parashtruar nga Shoqata e Psikologëve në Malishevë.

Rahim Morina: Ata kërkojnë mjete financiare kanë qenë edhe të unë në zyre.
Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, duhet t'i përgjigjemi, e njoftojmë se unanimisht e ka refuzuar kërkesën e lartcekur, pasi që Shoqata e psikologëve në Malishevë është përkrahur me mjete financiare nga Komuna e Malishevës sipas thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve.

Hashim Vrenezi: Në detaje se kam pa lexuar kërkesën si projekt me pëlqeu, Komuna ka bërë shpenzime të mëdha për COVID e jo edhe në natyra të tjera.

Alban Krasniqi: Është trend i kërkesave por disa si plotësojnë kriteret, si projekt mundet me qenë i mirë, kjo organizatë ka bërë një kërkesë por sipas procedurave kjo duhet t'i nënshtrohet shpalljeve në projekte prej Kulturës. Kur ka projekte të cilat janë pjesë e punëve duhet të behën shpallje publike për aplikim.

Raimonda Krasniqi: Edhe me herët kemi qaluar, sepse shumë nxënës kanë pas nevojë për psikolog dhe këshilla, por ne duhet përkrahë projekte të tilla kur kemi.

Filloreta Bytyçi: Megjithatë konsideroj ta rekomandojmë për kuvend për debat.

Hashim Vrenezi: Kërkesa të tilla kemi mbështetur si për bujqësi por edhe këtë kërkesë nëse e përkrahim nuk gabojmë.

Valon Krasniqi: Nuk jam ta rekomandojmë për kuvend këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: Mirë është Hashim me nda anën profesionale, se Ligji për Ojq thotë që të gjithë duhet t'i nënshtrohen shpalljeve në projekte të tilla. T'i kërkojmë DKRS fondin e mbetur për këtë pjesë.

Hashim Vrenezi: Natyra e kërkesës ja vlen të përkrahët në mundemi me kërkuar informata.

Rahim Morina: Kush jeni që të rekomandohet kjo kërkesë? Për ishin 3, kundër 3, vota e dyfishte ishte kundër nga kryesuesi.

Kërkesa nr.02/328 datë: 22.06.2021 të parashtruar nga z. Hasim Rudi - kryetar i fshatit Rud, Komuna e Malishevës, për ndihmë financiar për sigurimin e strehimit për z. Sabit Rudin.

Alban Krasniqi: Nuk luaj me integritet të njerëzve dhe kërkesa që nuk kanë bazë si të trajtohen. Pala duhet orientuar në banesa sociale që janë në proces të ndarjes, e ne mos të shkelim mbi çdo kriter.

Andaj duhet të orientohet kjo kërkesë te komisioni për ndarje të banesave.

Rahim Morina: Andaj Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes një shkrese përcjellëse vendos të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Unanimisht ishin 6 anëtarë që kërkesa t'i përcillet kryetarit të Komunës.

Kërkesën nr.02/327 datë: 22.06.2021 të parashtruar nga z. Latif Krasniqi banues në fshatin Kijevë, Komuna e Malishevës, për zgjidhjen e problemit të strehimit.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes kësaj shkrese përcjellëse ka vendosur të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/251 datë:25.06.2021 të parashtruar nga kryetari i fshatit Lladroc z. Nuhi Zogaj, lidhur me mos realizimin e projekteve në fshatit Lladroc të parapara për vitin 2021.

Rrahim Morina: KPF pas shqyrtimit të kësaj kërkesë përmes kësaj shkrese përcjellëse nga Drejtoria për Urbanizëm kërkon informacione;

Informacion lidhur me projektet e parapara për vitin 2021 për fshatin Lladroc, po ashtu kërkojmë informacione se pse këto projekte nuk janë realizuar deri me tani në këtë fshat.

Lista për të gjitha projektet e realizuara, në realizim dhe të pa realizuara të vitit 2021.

kërkesa nr.02/254 datë: 28.06.2021 të parashtruar nga Drejtoresha e Shoqatës Fatjona znj.Fatime Limaj nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, për ndarjen e një lokacioni për promovim të produkteve.

Rrahim Morina: Këtë kërkesë, përmes një shkrese përcjellëse Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht nga Drejtoria për Shërbime publike kërkon shqyrtimin e mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

kërkesa nr.02/252 datë: 28.06.2021 e parashtruar nga znj.Miradije Sopaj nga fshati Janqishte, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim të bashkëshortit të saj z. Adem Sopaj.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të miratohet me ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro).

Për ishin 3, kundër s'kishte, abstenime 3.

kërkesa nr.02/355 datë: 29.06.2021 e parashtruar nga zj.Ajshe Bytyçi nga fshati Shkozë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të miratohet me ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin për 6 anëtarë.

kërkesa nr.02/360 datë: 30.06.2021 e parashtruar nga z.Nezir Brahaj nga fshati Senik, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të miratohet me ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin për 6 anëtarë.

Kërkesa nr.02/355 datë:03.06.2021

Rrahim Morina: Si kërkesë nuk është e kompletuar me dokumentacion.

Kërkesa nr.02/361 datë: 01.07.2021

Alban Krasniqi: Ne si kërkesë mund ta votojmë vetëm pasi të plotësohet dokumentacioni, një vërtetim prej fondit të sigurimit shëndetësor a a është ndihmuar ndonjëherë, për çfarë po kërkon mjetet për udhëtim dhe dokumentacionin shëndetësor.

Unanimisht ishin për.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 14:30.

Procesmbajtësi

Najm Avdiqaj jur. i dip

